M. Jmov

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

# VENDIM

Nr. 942, datë 18.11.2015

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PLANIFIKIMIN DHE REALIZIMIN E FOTOGRAFIMIT AJROR TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 16, të ligjit nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores "Për planifikimin dhe realizimin e fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse sipas nenit 12, të ligjit nr.72/2012, që marrin nisma për fotografim ajror të territorit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

MILENA HARITO